



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



PLANI I PUNËS PËR VITET

2020-2022

Dhjetor, 2019



Përmbajtja

1	HYRJE	5
2	MANDATI I ZYRES SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI	6
2.1	Organizimi i ZRRE-së	7
2.2	Operimi i ZRRE-së	9
3	Struktura e Planit të punës	10
3.1	Integrimi i Tregut	10
3.2	Konkurrenca në sektorin e energjisë elektrike	11
3.3	Derregullimi i çmimeve	11
3.4	Siguria e furnizimit me energji elektrike	11
3.5	Pakoja e Energjisë së Pastër	12
3.6	Mbrojtja e Konsumatorëve në Nevojë	13
3.7	Rrjetet elektrike dhe termike	14
3.8	REMIT - Transparenca dhe Integrimi i Tregut të Energjisë	14
3.9	Alokimi i Kapaciteteve dhe Menaxhimi i Konxhestioneve	15
4	FINANCIMI I ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI	16
4.1	Planifikimi i të hyarve dhe shpenzimeve të ZRRE-së	16
4.2	Të hyrat	17
4.3	Donacionet	18
5	Shtojca I Planit të veprimit	19



SHKURTESAT

NA	Njësia e Administratës
RB	Raportet e Bilanceve
CAPEX	Investimet Kapitale
DM	Drejtor Menaxhues
DMK	Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve
NQ	Ngrohje Qendrore
EBRD	Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë
ZRRE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
ERRA	Asosacioni Regjional i Rregullatorëve të Energjisë
DTEST	Departamenti për Furnizim me Energji dhe Strukturë të Tregut
BE	Bashkimi Evropian
HC	Hidrocentral
TI	Teknologji Informative
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KOSTT	Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Kosovës
LAN	Rrjeti i Zonave Lokale
DLL	Departamenti Ligjor dhe i Licencimit
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MP	Marrëdhëniet me Publik
DTÇ	Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve
OPEX	Shpenzimet Operative
AT	Asistent Teknik
TC	Termocentral



USAID

Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

SKE

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë

BB

Banka Botërore



1 HYRJE

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është themeluar në vitin 2004, në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë. ZRRE luan një rol të rëndësishëm në transformimin dhe monitorimin e sektorit të energjisë në Kosovë, procesin e licencimit, konkurrencën dhe funksionimin e rregulluar të tregut të energjisë, ngrohjes qendrore dhe gazit natyror, si dhe funksionimin e rregulluar të kompanive energjetike, të cilat mund të karakterizohen si monopole.

Plani i punës i ZRRE-së zhvillohet mbi baza vjetore ose në një periudhë afatmesme, në varësi të kërkesës për krijimin e një vizioni më të qartë për trendët e zhvillimit të sektorit, dhe transformimin e tregut të energjisë në Kosovë dhe më gjerë. Dy Plane të Punës të ZRRE-së u miratuan nga Bordi, njëri prej të cilëve ishte për një vit (2018), ndërsa tjetri mbulon një periudhë 3-vjeçare, kryesisht duke renditur aktivitete që do të zhvilloheshin, por edhe kërkesa ligjore dhe strategjike të sektorit të energjisë, krahas Strategjisë së Energjisë dhe Planit të Zbatimit të Strategjisë Kombëtare. Ky plan i punës është plan i reviduar i planit të periudhës paraprake dhe mbulon periudhën 2020-2023 në përputhje me trendët e zhvillimit të sektorit.

Kërkesa për një Plan të Punës të ZRRE-së, përveç që është një kërkesë ligjore, është mjaft e nevojshme, duke marrë parasysh të gjitha ndryshimet në sektorin e energjisë, të cilat pritet të sjellin një transformim të rëndësishëm në treg.

Plani i Punës ka për qëllim zhvillimin e mekanizmave për respektimin e afateve dhe procedurave si një përpjekje për të realizuar qëllimet operative:

- a. Përshkrimi i objektivave dhe qëllimeve të Planit të Veprimit;
- b. Rezultatet e pritura;
- c. Renditja e veprimeve të nevojshme;
- d. Përcaktimi i mjeteve të veprimit;
- e. Marrëdhënia ndërmjet veprimeve të tilla (nëse aplikohet); dhe
- f. Afatet e veprimit;

Plani i Punës është një faktor i rëndësishëm përcaktues për kostot e ZRRE-së, dhe është përgatitur në përputhje me nenin 22 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Nr. 05/L-084.

Publikimi i këtij Plani të Punës do të fuqizojë transparencën dhe përgjegjshmërinë, duke lejuar të gjithë palët e interesit të sigurojnë që aktivitetet e planifikuara për çdo vit radhazi të jenë në përputhje me detyrat ligjore dhe funksionet e ZRRE-së.



2 MANDATI I ZYRES SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është një agjenci e krijuar me një qëllim të veçantë dhe objektiva të përcaktuara kryesisht nga Ligji për Energji, Ligji për Rregullatorin e Energjisë dhe Ligji për Energjinë Elektrike, si dhe akte të tjera legjislative. Si rezultat i mandatit dhe rolit të saj, ZRRE është një figurë kyçe në sektorin e energjisë në Kosovë dhe një pikë qendrore kontakti për të gjitha entitetet e përfshira në treg. ZRRE luan një rol aktiv në zhvillimin, miratimin dhe zbatimin e një kornize rregullative të përshtatshme për zhvillimin dhe funksionimin e një tregu konkurrues të energjisë në Kosovë.

ZRRE është e organizuar në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (Kapitulli II i Ligjit) dhe Manualin e Operimeve të ZRRE-së. Misioni i ZRRE-së është për krijimin e një tregu të qëndrueshëm të energjisë në Kosovë, të bazuar në parimet e transparencës dhe konkurrencës së lirë, që shtojnë vlerën si për konsumatorët ashtu edhe për ndërmarrjet.

Objektivat e ZRRE-së janë si në vijim:

- a. Të hartoj rregulla, rregullore, procedura dhe metodologji për krijimin dhe funksionimin e një tregu efektiv dhe të dobishëm të energjisë;
- b. Të zhvilloj metodologji të të hyrave dhe miratoj tarifat për aktivitetet e rregulluara;
- c. Të zhvilloj sisteme për monitorimin e cilësisë së shërbimit dhe pajtueshmërinë e të licencuarit; dhe
- d. Të kërkoj zbatimin dhe pajtueshmërinë e të licencuarve me rregullat, procedurat dhe metodologjitë e përmendura më lartë, dhe të veprojnë si një faktor balancues ndërmjet pjesëmarrësve të tregut.

Këto funksione të ZRRE-së ushtrohen përmes Bordit, të cilit me ligj i janë përcaktuar detyrimet e mëposhtme (neni 15 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë):

- a. të miratoj politika rregullative dhe operative të ZRRE-së;
- b. të organizoj dhe mbikëqyr punën e ZRRE-së;
- c. të mbikëqyr zbatimin e buxhetit dhe menaxhimin financiar të ZRRE-së dhe të miratoj raportet dhe deklaratat financiare;
- d. të organizoj rekrutimin, emërimin dhe mbikëqyrjen e punës së personelit të punësuar nga ZRRE;
- e. të miratoj pagesën dhe kushtet e tjera të punësimit për stafin e ZRRE-së;
- f. të merr vendime dhe nxjerr rregulla dhe akte të tjera nënligjore të nevojshme për zbatimin e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.



2.1 Organizimi i ZRRE-së


Struktura organizative e ZRRE-së është përcaktuar nga Bordi i ZRRE-së, në bazë të përgjegjësisë dhe detyrave të përcaktuara me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084 .

Në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Zyra e Rregullatorit për Energji udhëhiqet nga Bordi prej pesë anëtarësh, përgjegjës për miratimin e politikave operative; miratimin, në përputhje me procedurat e konsultimit publik, të legjislacionit sekondar, rregullave, të lëshuara nga ZRRE; mbikëqyrjen e buxhetit dhe menaxhimin financiar; si dhe aprovimin e raporteve dhe pasqyrave financiare të ZRRE-së.

Struktura themelore përbëhet nga Bordi, Drejtori Menaxhues pesë departamente operative dhe Njësia e Administratës. Drejtori Menaxhues, Departamentet dhe Njësia e Administratës u krijuan në përputhje me detyrat operationale të ZRRE-së. Secili departament, përbëhet nga njësitë e tyre organizative. Katër departamentet operative janë:

- Departamenti Ligjor dhe i Licencimit (DLL),
- Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK),
- Departamenti i Tregut të Energjisë (DTE),
- Departamenti për Energji Termike dhe Gas Natyror (DETGN),
- Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve (DTÇ).

Struktura organizative aktuale e ZRRE është paraqitur më poshtë në një grafik të thjeshtuar



Drejtori Menaxhues (DM)

Drejtori menaxhues i koordinon aktivitetet midis Bordit dhe stafit profesional dhe administrativ; është përgjegjës për implementimin e të gjitha vendimeve të Bordit të Rregullatorit, në mënyrë



aktive informon dhe këshillon Bordin për zhvillimet në sektorin Energjetik, mbështet Bordin e Rregullatorit për të siguruar që të gjitha aktivitetet e Rregullatorit janë kryer në përputhje me ligjet, rregulloret dhe politikat e Rregullatorit si dhe mbikëqyrë punën e departamenteve të Rregullatorit. Drejtori menaxhues i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt Bordit dhe ushtron detyrën nën drejtimin dhe udhëzimet e Bordit, në pajtim me Manualin e operimeve të Rregullatorit.

Departamenti Ligjor dhe i Licencimit (DLL)

Departamenti Ligjor dhe i Licencimit është përgjegjës për zhvillimin e legjislacionit sekondar, vlerësimin e aplikacioneve për licencim nga ndërmarrjet e energjisë, si dhe vlerësimin e aplikacioneve për autorizim për zhvillimin e kapaciteteve të reja. Ky departament gjithashtu angazhohet në mbikëqyrjen dhe monitorim e aktiviteteve të të licencuarve.

Departamenti i Tregut të Energjisë (DTE)

Departamenti i Tregut të Energjisë është përgjegjës për strukturën e tregut, monitorimin e performancës së pjesëmarrësve të tregut, vlerësimin dhe analizën e të dhënave në sektorin e energjisë. Departamenti gjithashtu monitoron konkurrencën dhe sjelljen e pjesëmarrësve të tregut në mënyrë objektive, transparente dhe jo-diskriminuese.

Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve (DTÇ)

Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve është përgjegjës për vlerësimin e aplikacioneve tarifore të ndërmarrjeve të licencuara, të cilat i paraqiten Bordit për miratim, monitorimin e zbatimit të shpenzimeve operacionale dhe kapitale përmes rishikimeve tarifore; ndërmarrjen e të gjitha masave për të siguruar që tarifatat të jenë kost-reflektive, të arsyeshme, jo-diskriminuese dhe të bazuara në kritere objektive, si dhe të vendosura në mënyrë transparente, duke marrë parasysh mbrojtjen e konsumatorëve.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK)

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve është përgjegjës për rishikimin dhe zgjidhjen e ankesave dhe mosmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorëve dhe ndërmarrjeve të energjisë, operatorëve të sistemit dhe ndërmarrjeve të energjisë, dhe ndërmjet ndërmarrjeve të energjisë. Në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësisë të tij, ky departament bashkëpunon me të gjitha institucionet dhe organizatat që përfaqësojnë konsumatorët.

Departamenti për Energji Termike dhe Gaz Natyror (DETGN)

Departamenti për Energji Termike dhe Gaz Natyror është përgjegjës për rishikimin dhe zbatimin e strategjive, standardeve të performancës dhe praktikave të tjera operative në sektorë të tillë. Ky departament parashikon monitorimin e ndërmarrjeve të licencuara, duke mbledhur, analizuar dhe vlerësuar të dhënat dhe informacionet përkatëse, dhe gjithashtu kontribuon në zhvillimin e sistemeve të raportimit të ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore, duke u përqëndruar kështu në



elementët teknikë dhe teknologjikë, dhe thjeshtimin e masave nxitëse dhe çapeve të efikasitetit. Ai gjithashtu do të bashkëpunojë me departamentet e tjera të ZRRE-së, duke siguruar mbështetje teknike dhe ekspertizë për çështje që lidhen me energjinë termike dhe gazin natyror.

Njësia e Administratës (NA)

Njësia e Administratës mbështet funksionimin e ZRRE-së, duke siguruar administrimin e financave, organizimin e procedurave efektive të rekrutimit nga ZRRE, koordinimin e trajnimit të stafit të ZRRE-së, furnizimin dhe mirëmbajtjen e furnizimeve për zyra, dhe ndihmon në rregullimin e zyrave, dhënien e hapësirave të zyrave të përshtatshme për përdorim nga stafi i ZRRE-së.

2.2 Operimi i ZRRE-së

Sa i përket procedurës, është e rëndësishme të theksohet se ZRRE tashmë ka miratuar një Manual të Operimeve, duke adresuar të gjitha operimet e ZRRE-së në procedura zyrtare të zbatueshme. Këto procedura kanë lehtësuar funksionimin e ZRRE-së, duke përmirësuar kështu efektivitetin në ushtrimin e detyrave ditore dhe kërkesave ligjore.

Sa i përket sistemeve, ZRRE përdor një Rrjet të Zonës Lokale (LAN) dhe i gjithë personeli (përfshirë anëtarët e Bordit) janë të lidhur me sistemin kompjuterik (mainframe). Ekziston gjithashtu një qasje e përgjithshme dhe e vazhdueshme në shërbimet e internetit dhe postën elektronike.

Nevojat thelbësore të ZRRE-së, që duhet të mbështeten nga një sistem solid i menaxhimit të informacionit dhe dokumenteve, janë të njohura tashmë, dhe ZRRE ka një sistem aplikimi që duhet të aktivizohet për të siguruar një punë më të mirë dhe rrjedhën e detyrave, si dhe për të përmirësuar efikasitetin në drejtim të menaxhimit të stafit .

ZRRE gëzon një reputacion pozitiv të përfshirjes në procese efektive të konsultimit publik rreth vendimmarrjes së saj rregullative. Ruajtja e këtij reputacioni nënkupton angazhimin e palëve të interesuara në zhvillimin e rregullave dhe rregulloreve, si dhe gjatë implementimit të tyre. Rritja e transparencës dhe përfshirja e palëve të interesit, shoqërisë civile dhe organizatave mediale në procesin e vendimmarrjes mund të rrisin ndjeshëm qëndrueshmërinë e vendimeve rregullative dhe pranimin e vendimeve të tilla nga ana e publikut.

ZRRE është një agjenci rregullatore relativisht e vogël, me gjithsej 33 pozita, përfshirë anëtarët e Bordit. Aktualisht, të punësuar janë 29 persona. Madhësia e organizatës imponon domosdoshmërinë e fleksibilitetit, por edhe njëkohësisht, shfrytëzim të madh të të gjitha burimeve (njerëzore, financiare, teknike) të organizatës.



3 STRUKTUARA E PLANIT TË PUNËS

Periudha e tri viteve të ardhshme pritet të jetë sfiduese për ZRRE-në. Ekziston një nevojë e dukshme e ZRRE-së që të vazhdojë të mbështetet nga asistenca teknike gjatë periudhës së planit të punës. Disa nga zhvillimet që kërkojnë vëmendje të veçantë nga Rregullatori në vitet e ardhshme janë:

- a. Integrimi i tregut me Shqipërinë dhe rajonin;
- b. Rritja e Konkurrencës në Sektorin e Energjisë Elektrike;
- c. Procesi i derregullimit të çmimeve (tregjet me shumicë dhe pakicë);
- d. Siguria e furnizimit me energji elektrike;
- e. Paketa e Energjisë së Pastër dhe sfidat e integritit të një niveli më të lartë të BRE-ve
- f. Mbrojtja e konsumatorëve në nevojë për shkak të rritjes së kostove të furnizimit
- g. Rrjetet Elektrike dhe Termike;
- h. Monitorimi i Tregut (REMIT)
- i. Alokimi i Kapaciteteve dhe Menaxhimi i Konxhestioneve
- j. Përmirësimet operative brenda ZRRE-së
- k. Pavarësia funksionale dhe financiare e ZRRE-së

3.1 Integrimi i Tregut

Integrimi i tregut të energjisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor është një temë e trajtimit të përkushtuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe pjesëmarrësit e tjerë të sektorit të energjisë në rajon dhe më gjerë. Janë ndërmarrë studime të shumta për të siguruar integrimin e tregut, por deri më tani, nuk ka plan konkret për integrimin e të gjitha tregjeve të Ballkanit Perëndimor në një treg të vetëm të përbashkët energjetik. Sidoqoftë, shumica e vendeve të rajonit tashmë kanë hartuar planet e tyre për integrimin e pjesshëm të tregut, duke synuar krijimin e tregjeve të përbashkëta ndërmjet një numri më të vogël të pjesëmarrësve, me synimin për të zgjeruar integrimin e tillë më tej me tregjet e reja anëtare të rajonit.

Kosova ka një pozicion të avancuar drejt krijimit të një tregu të përbashkët me Shqipërinë, i cili në fakt do të ishte bashkimi i parë konkret i dy tregjeve në rajon. Sidoqoftë, mbetet shumë për t'u bërë në funksionimin e një tregu të përbashkët, dhe për këtë arsye, ZRRE do të përfshij, brenda planit të punës, veprimet e ndërlidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi me integrimin e tregut me Shqipërinë. Në të ardhmen, ZRRE do të angazhohet për zhvillimin e një modeli të ri të tregut, i cili do të ishte i përshtatshëm për integrimin me tregun e Shqipërisë, dhe do të jetë në gjendje të integrojë kapacitete të reja gjeneruese. Kjo është padyshim është një nga sfidat kryesore të viteve në vijim, megjithatë ZRRE pret që të ketë mbështetjen e donatorëve të shumtë dhe palëve të tjera të interesit në sektorin e energjisë, në mënyrë që të jetë në gjendje të zhvillojë një model funksional të tregut. Kontribut i rëndësishëm në drejtim të integritit të tregut është ofruar nga USAID, përmes projektit të tij REPOWER-KOSOVO, ndërsa për rajonin e Evropës Jug-Lindore, nën Iniciativën e Tregut të Energjisë Elektrike (EMI), USEA është duke punuar me operatorët e transmisionit dhe tregut dhe



rregullatorët në të gjithë rajonin për të të përmirësuar balancimin e sistemit, integrimin e energjisë së pastër dhe prokurimin, lidhjet e tregut dhe shkëmbimet e energjisë.

Në kuadër të kësaj iniciative, gjatë periudhës 2020-2025, do të adresohet integrimi i pjesshëm i tregjeve të energjisë, ku Kosova synon të integrojë tregun e saj me Shqipërinë, ndërsa në vitin 2025, qëllimi është të krijohet një treg i përbashkët për të gjithë rajonin e Evropës Juglindore . Brenda këtij viti, rajoni do të hartojë një plan të detajuar për përmbushjen e një objektiv të tillë, dhe të gjitha përgjegjësitë e rregullatorëve përkatës (përfshirë ZRRE-në) ndaj integritimit duhet të përcaktohen. Kështu, ZRRE pritet të angazhohet në këtë drejtim, brenda periudhës së mbuluar nga ky Plan.

3.2 Konkurrenca në sektorin e energjisë elektrike

Në konsultim me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe autoritetet përkatëse që monitorojnë ndihmën shtetërore, Zyra e Rregullatorit për Energji, të paktën çdo dy (2) vjet, do të rishikojë funksionimin e tregut të energjisë elektrike, dhe do të vendos të gjitha masat e nevojshme dhe proporcionale për të rritur konkurrencën dhe të siguroj funksionimin e duhur të tregut. Duhet nënvizuar se ky vlerësim dyvjeçar nuk është i lidhur me hetimet e mundshme të abuzimit të pretenduar të pozitës dominuese, në përputhje me Ligjin për Konkurrencën.

Vitet e fundit, është bërë punë e konsiderueshme përgatitore për të zhvilluar marrëveshje ligjërish të detyrueshme të nevojshme për të rritur konkurrencën në furnizimin me energji elektrike. ZRRE ka zhvilluar një plan veprimi, përmes Udhëzimeve për Liberalizimin e Tregut, i cili përcakton një rrugë të synuar drejt derregullimit të çmimeve (shih seksionin 1.5 më poshtë). Përveç procedurave përfundimtare për ndryshimin e furnizuesit, ZRRE ka krijuar mekanizmat e sigurisë për të mbrojtur konsumatorët, veçanërisht konsumatorët shtëpiak, në një treg konkurrues. Kjo ka përfshirë emërimin e një "furnizuesi të garantuar", i cili do të luante rolin e një Furnizuesi të Mundësisë së Fundit (FMF), në rast se një kontratë ekzistuese e konsumatorit me një furnizues skadon ose anulohet përpara se konsumatori të hyjë në një kontratë të re furnizimi.

3.3 Derregullimi i çmimeve

ZRRE ka filluar derregullimin në tregun e energjisë me shumicë, për të vazhduar më tej me një plan konkret për deregullimin e çmimeve në tregun e energjisë me pakicë. Në këtë këndvështrim, Bordi i ZRRE-së ka miratuar "Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike", i cili, ndër të tjera, përcakton gjithashtu derregullimin e çmimeve të energjisë elektrike dhe afatin kohor të implementimit.

Në këtë drejtim, brenda këtij viti, ZRRE gjithashtu do të hartojë një studim të vlerësimit të tregut të energjisë elektrike dhe do të marrë më tej masa për derregullimin e mëtutjeshëm të tregut bazuar në gjetjet e studimit.

3.4 Siguria e furnizimit me energji elektrike

Siguria e furnizimit me energji elektrike ka qenë dhe vazhdon të jetë ndër sfidat kryesore për sektorin e energjisë në Kosovë. Edhe përkundër përpjekjeve të mëdha dhe të vazhdueshme, Kosovës i duhet



ende të zhvilloj kapacitete gjeneruese të qëndrueshme. Kjo në masë të madhe ka penguar zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, për shkak të pamundësisë për të garantuar furnizimin e pandërprerë me energji elektrike.

ZRRE-ja ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në zhvillimin e sektorit të BRE-ve, ku si rezultat i Skemave të Mbështetjes së BRE-ve, shumë projekte janë implementuar, dhe pritshmëritë janë që deri në vitin 2020, Kosova të arrijë objektivin e saj të detyrueshëm prej 25% të burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Sidoqoftë, në asnjë mënyrë BRE-të nuk mund të arrijnë një pjesë mbizotëruese në gjenerimin e energjisë, për shkak të pjesëmarrjes së tyre prej 5% në gjenerimin e brendshëm, dhe për më tepër, nuk është dëshmuar që BRE-të janë në gjendje të zëvendësojnë fuqinë e konsumit bazë, të paktën jo për ca kohë. Bazuar në atë që u tha më lartë, Kosova u detyrua të planifikojë zhvillimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për të zëvendësuar kapacitetet e TC Kosova A, që është dashur të dekomisionohej në 2017.

Kështu, në vitin 2018, Qeveria e Kosovës lidhi një kontratë tregtare me ContourGlobal. Një kusht në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë (MBE) është që Qeveria të transferojë përgjegjësitë e saj tek një entitet tjetër nën pronësinë e saj për të marrë përsipër përgjegjësitë e Blerësit, sipas MBE-së. Ndërmarrja e Re Energjetike e Kosovës (NKEC) është krijuar tashmë për të vepruar si një konsumator me shumicë, i licencuar për furnizim me shumicë (tregti) me licencim nga Zyra e Rregullatorit për Energji. Sipas këtij plani, TC Kosova e Re pritet të hyjë në veprim deri në vitin 2023, dhe pritet të jetë projekti më i madh i sektorit të energjisë që nga lufta. Kjo do të kërkojë një angazhim të madh nga ana e ZRRE-së, sa i përket sigurimit të kornizës së nevojshme rregullative për të lejuar zbatimin e projektit. Së bashku me ekspertizën e brendshme, ZRRE mund të mbështetet në ekspertizën e jashtme të dhënë përmes USAID për përmbushjen me sukses të detyrimeve që rrjedhin nga një marrëveshje e tillë. Kohët e fundit, ZRRE ka vendosur në konsultim publik një dokument i cili do të imponojë Obligimet e Shërbimit Publik (OSHP) për të gjithë furnizuesit në tregun e energjisë në Kosovë, për të lejuar kthimin e investimeve në Projektin Kosova e Re. Dokumenti duhet të konsultohet me të gjitha palët e interesit, përfshirë Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë.

3.5 Pakoja e Energjisë së Pastër

Parlamenti Evropian kohët e fundit miratoi Pakon e Energjisë së Pastër për të gjithë Evropën e cila përcakton vizionin e BE për objektivat e politikës së energjisë së ripërtëritshme dhe efikasitetit të energjisë për 2030. Pakoja e energjisë së pastër e vendos në epiqendrën e sistemit të energjisë dhe parashikon një model të rinovuar të tregut i cili rrit stimuj për fleksibilitet dhe menaxhim të kërkesës në mënyrë që të përmirësojë aftësinë e rrjeteve të energjisë për të absorbuar një nivel të rritur të depërtimit të llojeve të ndryshme të burimeve të energjisë së ripërtëritshme. Kjo Direktivë shfuqizon dhe zëvendëson pakon e tretë e cila tashmë është detyruese për Kosovën. Zbatimi i Direktivës për Palët Kontraktuese EnCT nuk ka gjasa të bie brenda afatit të planit aktual të punës, megjithatë ZRRE duhet të studiojë me kujdes implikimet e Pakos në hartimin e tregut dhe të rregullojë politikën e saj të ardhshme në përputhje me këto implikime.

Masat konkrete drejt përmirësimit të përputhshmërisë së Skemës Mbështetëse të energjisë së ripërtëritshme dhe drejt rritjes së zbatimit të skemës aktuale përfshijnë:



- a. Rishikimin e Rregullës për Skemën Mbështetëse për të prezantuar masat që përputhen me tregun;
- b. Prezantimin e një Sistemi të Certifikatës së Originës për BRE-të;
- c. Studimin mbi kapacitetet e shpërndarjes për të integruar BRE-të; dhe
- d. Inicimin e fushatave konkrete të ndërgjegjësimit në lidhje me efikasitetin e energjisë, etj.

3.6 Mbrojtja e Konsumatorëve në Nevojë

Kosova ka marrë përsipër obligime kontraktuale përballë Bashkimit Evropian, përmes Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, dhe nevojën e saj të menjëhershme për të zhvilluar një sistem energjetik që është në përputhje me qëllimin evropian për të pasur një treg të vetëm të energjisë në Evropë. Prandaj, duhet të hartohen politika të qarta për të adresuar të gjitha sfidat dhe pengesat në rrugën drejt një tregu të integruar rajonal, dhe pastaj evropian, të energjisë.

Në vitin 2016 Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi ligjet e sektorit të energjisë, duke transpozuar kështu Paketën e Tretë të Direktivave të Energjisë të Komisionit Evropian. Kjo solli ndryshime të rëndësishme në sektorin e energjisë, duke përfshirë domosdoshmërinë e derregullimit të menjëhershëm të çmimeve të energjisë me shumicë, që do të pasohej nga një derregullim i çmimeve me pakicë po ashtu. Për shkak të pranisë së një subvencionimi të nivelit të lartë të tarifave të energjisë me pakicë, derregullimi i tyre do të shkaktonte çmime të papërbalueshme të energjisë për konsumatorët në nevojë, dhe do t'i vendoste konsumatorët e tillë në një pozicion të papranueshëm për perspektivat tona sociale dhe ekonomike.

Duke pasur parasysh tranzicionin e energjisë dhe zhvillimin e planifikuar për një periudhë 5-vjeçare, si dhe ndikimin që të gjitha këto procese mund të kenë në situatën e konsumatorit, "varfëria energjetike" nuk është vetëm çështje energjetike, dhe nuk mund të adresohet vetëm nga Rregullatori. Kjo është arsyeja pse kjo çështje duhet të adresohet si çështje e përbashkët ndërmjet qeverisë, rregullatorit dhe pjesëmarrësve të tjerë të sektorit të energjisë.

Qëllimi i Rregullatorit është një treg i energjisë që funksionon për të gjithë konsumatorët, përfshirë ata në rrethana të ndjeshme, ndërsa furnizuesit e tregut me shumicë duhet të zbatojnë mekanizmat e miratuar nga Rregullatori për të mbrojtur konsumatorët në nevojë në rrethana specifike. Një rol kryesor në mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë është ndërmarr nga Qeveria, në drejtim të sigurimit të subvencioneve të drejtpërdrejta për konsumatorët në nevojë.

Në përmbushjen e detyrimit për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë, ZRRE ka iniciuar së bashku me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale krijimin e një grupi punues për hartimin e politikave për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë. Ky grup tashmë është krijuar, dhe aktivitetet e tij janë mbështetur nga NARUC dhe Banka Botërore. Grupi është i orientuar drejt përpilimit të një dokumenti që do të përmbante propozime rreth politikave për të mbrojtur konsumatorët në nevojë, dhe dorëzimin e tij për miratim nga Qeveria e Kosovës.

Qasja e këtij Grupi është bazuar në propozimin e dy mekanizmave kryesorë për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë:



- a. Mbështetje e drejtpërdrejtë financiare dhe mbështetje me programet investive të efijencës së energjisë për konsumatorët në nevojë, dhe
- b. Mbështetje jo-financiare, e cila përfshin mbrojtjen kundër shkyçjes, ngritjen e vetëdijes për efijencën e energjisë, zhvillimin e procedurave dhe politikave për të identifikuar dhe matur "ndjeshmërinë" etj.

3.7 Rrjetet elektrike dhe termike

Karakteristikat unike të sektorit të energjisë, përkatësisht domosdoshmëria e vazhdimësisë së sigurisë së furnizimit dhe obligimeve të shërbimit publik, imponojnë kërkesën për një kornizë specifike rregullative, në të cilën konkurrenca dhe ndërmarrjet private bashkëveprojnë. Një numër aktivitesh specifike në lidhje me rrjetet janë realizuar dhe do të kryhen në këtë periudhë, si shtesë ndaj punës rutinore të ZRRE-së drejt përmirësimit të rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

ZRRE ka miratuar një "Program të Pajtushmërisë", të zhvilluar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) në përputhje me nenin 18 të Licencës së këtij Operatori, dhe nenin 15 të Ligjit për Energjinë Elektrike. Programi i Pajtushmërisë prezanton aranzhimet për të siguruar që operacionet e shturura të shpërndarjes janë kryer mbi baza jo-diskriminuese. ZRRE ka për qëllim të bëjë monitorimin e një programi të tillë në vitet në vijim.

Marrëveshjet e Shturjes të paraqitura në Paketën e Tretë të Energjisë të Komisionit Evropian (KE) për operacionet e transmetimit kërkojnë që ZRRE të certifikojë KOSTT si Operator të Sistemit të Transmisionit, pavarësisht licencës së lëshuar KOSTT-it për këtë aktivitet në 2006. ZRRE filloi procesin e certifikimit në maj 2017. Më 24 shtator 2018, ZRRE-ja miratoi një vendim paraprak për certifikimin e KOSTT, në zbatim të nenit 39 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. ZRRE pret që pasi të marrë një Opinion nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (ECS) për vendimin paraprak të ZRRE-së, do të përfundojë procesin e certifikimit duke lëshuar një vendim përfundimtar në fillim të vitit 2019.

Në tetor 2018, ZRRE përfundoi rishikimin e Kontrollit Shumëvjeçar të Çmimeve për operatorët e shpërndarjes dhe transmetimit. Përditësimet vjetore në vitet e ardhshme do të përqendrohen në mbledhjen dhe monitorimin e të dhënave të zhvilluara.

Sa i përket energjisë termike, aktivitetet janë të përqendruara në bashkëpunim dhe ofrimin e udhëzimeve për ndërmarrjet e energjisë termike rreth planifikimit të rrjeteve të energjisë termike (rrjetet e shpërndarjes). Projektet e planifikuara të zgjerimit duhet të lejojnë adresimin e kërkesave për kyçe në rrjet që të sigurojë furnizimin me energji termike për ngrohje; ndërsa projektet e rehabilitimit të rrjetit do të ndikojnë në uljen e humbjeve dhe përmirësimin e cilësisë së furnizimit. Në këtë kornizë, ne synojmë një ngritje dhe forcim të aktiviteteve në lidhje me monitorimin dhe kontrollin e projekteve të investimeve dhe kostot përkatëse të kapitalit.

3.8 REMIT - Transparenca dhe Integrimi i Tregut të Energjisë

Monitorimi i tregut të energjisë në vendet e EJT-së është përballur dhe vazhdon të përballlet me sfida të shumta për shumë vite me radhë. Ndërkohë, ndikimi në tregun e energjisë nuk ka qenë shumë i ndjeshëm, pasi që në vitin 2011, Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER) iu



dha një detyrë shtesë, në përputhje me Rregulloren (BE) nr. 1227/2011 të Këshillit Evropian dhe Këshillit për Tregtinë me Shumicë të Energjisë Integritetit dhe Transparencës (REMIT) miratuar më 8 dhjetor 2011.

REMIT paraqet një kornizë logjike për sektorin, në identifikimin dhe sanksionimin e tregtisë së brendshme dhe abuzimit të tregtisë në tregjet me shumicë të energjisë në të gjithë Evropën.

Përgjegjësitë në lidhje me shqyrtimin REMIT mund të klasifikohen në katër shtylla kryesore:

- a. Koordinimi i Autoriteteve Rregullative Kombëtare (NRA- National Regulatory Authorities) për çështjet e politikave të përgjithshme REMIT, përfshirë udhëzimet për NRA dhe bashkëpunimin me NRA, Autoritetin Evropian të Tregut të Aksioneve (ESMV), autoritetet financiare kombëtare dhe autoritetet e konkurrencës, si dhe autoritete të tjera përkatëse në politikat e REMIT, dhe mbledhjen e të dhënave si dhe transparencën;
- b. Sigurimi i udhëzimeve për respektimin e transparencës në REMIT, dhe raportimin e detyrimeve ndaj palëve të jashtme, si dhe mbledhjen e të dhënave për vlerësimin dhe monitorimin e tregjeve të energjisë me shumicë, përfshirë regjistrimin e palëve raportuese, ofrimin e udhëzimeve për mbledhjen e të dhënave përmes Paketës së Raportimit REMIT në zbatim të Rregullores REMIT, dhe në bashkëpunim me MSC, për të siguruar që të dhënat janë të një cilësie të mjaftueshme për t'u përdorur për qëllime të mbikëqyrjes;
- c. Futja e mekanizmave për shpërndarjen e të dhënave të mbledhura me NRA, autoritetet kompetente financiare në Shtetet Anëtare, autoritetet kombëtare të konkurrencës, ESMA dhe autoritetet e tjera përkatëse (d.m.th. Akademia dhe publiku);
- d. Zhvillimi, avancimi dhe mirëmbajtja e Sistemeve të Informacionit të Agjencisë REMIT, përfshirë Regjistrin Evropian të Akterëve të Tregut, për të mbledhur dhe analizuar të dhënat dhe informacionet e tjera.

Përkundër faktit se vendet e EIL nuk janë anëtare të ACER ende, së shpejti këto vende do të jenë të detyruara të krijojnë korniza ligjore dhe mekanizma për zbatimin e REMIT. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka krijuar një Grup Punues për Implementimin e REMIT, i cili do të hartojë një kornizë të duhur zbatimi. Sipas planit, ai do të zhvillojë një kornizë të përbashkët ligjore për të gjitha vendet e EIL-së, përfshirë Kosovën. Pas krijimit të kushteve për zbatim, REMIT i nënshtrohet një "testimi", i cili është planifikuar të zgjas për një periudhë 3-vjeçare. Kjo konsiderohet të jetë kohë e mjaftueshme për të gjitha vendet për t'u njohur me një detyrim të tillë, dhe pas kësaj periudhe, implementimi i REMIT për vendet anëtare të Sekretariatit do të jetë i detyrueshëm. Që ZRRE të përgatitet për përmbushjen e këtij detyrimi, një përfaqësues i ZRRE-së është pjesë e grupit punues REMIT në Sekretariat. Pritet që periudha përgatitore REMIT të përfshihet në planin e punës për tre vitet e ardhshme.

3.9 Alokimi i Kapaciteteve dhe Menaxhimi i Konxhestioneve

Më 29 korrik 2011, ACER miratoi Udhëzuesin për Alokimin e Kapaciteteve dhe Menaxhimin e Konxhestioneve për energjinë elektrike (Rregullorja CACM).

Këto udhëzime dhe kodet e rrjetit që do të zhvillohen pas tyre do të parashikojnë kornizën ligjore dhe kërkesat për Operatorët e Sistemit të Transmisionit si dhe shkëmbimet e energjisë për funksionimin e



një tregu të integruar të energjisë elektrike në terma afatgjatë, brenda afateve "një-ditë përpara"(day-ahead) dhe brenda ditës.

Në bazë të planit të azhurnuar të energjisë elektrike të EC/ACER/ENTSO-E, dy kode rrjeti që do të zhvillohen në përputhje me CACM janë:

- a. Alokimi i Kapaciteteve dhe Menaxhimi i Konxhestioneve për afatet brenda ditës dhe një-ditë përpara;
- b. Alokimi i Kapaciteteve për periudha afatgjata;

Si rezultat, Grupi i Punës CACM në Sekretariatit e Energjisë, i cili gjithashtu përfshin ZRRE-në, do të zhvillojë në vitin 2019 një metodologji të përbashkët për përcaktimin e vëllimeve të disponueshëm të kapaciteteve midis zonave të tenderimit, kriteret për të vlerësuar efikasitetin dhe një proces rishikimi për përcaktimin e zonave të tenderimit.

4 FINANCIMI I ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGI

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) gëzon statusin e një "agjensionit të pavarur". Kushtetuta e Republikës së Kosovës parashikon që agjencitë e pavarura, janë institucione të krijuara nga Kuvendi bazuar në ligjet përkatëse që rregullojnë krijimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Agjencitë e pavarura ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës. Kjo do të thotë që ZRRE-ja duhet të ketë pavarësi të plotë në planifikimin dhe shpenzimin e të ardhurave të dedikuara, të garantuara me Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi.

Çështja e pavarësisë financiare është rregulluar kryesisht nga Direktivat e BE-së, të cilat parashikojnë që Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që autoritetet rregullative ose agjencitë e pavarura duhet të jenë në gjendje të marrin vendime autonome në mënyrë të pavarur nga çdo organ politik, përfshirë mënyrat përmes të cilave ato ushtrojnë mandatet e tyre, njerëzit që duhet të rekrutojnë etj. Kjo do të thotë që Zyra duhet të gëzojë alokime të dedikuara buxhetore dhe pavarësi në zbatimin e buxhetit të tillë, me një theks të veçantë në vendimet për shpenzimin e fondeve në dispozicion, për ushtrimin e mandatit siç parashikohet nga legjislacioni në fuqi.

Përveç që garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Direktivat e BE-së, pavarësia financiare përcaktohet qartë me legjislacionin e miratuar nga Kuvendi i Kosovës, një pako në përputhje me Pakon e Tretë të Energjisë "aquis". Legjislacioni aktual parashikon qartë se të ardhurat e ZRRE-së janë "të ardhura të dedikuara", dhe në lidhje me këtë, ZRRE ka të drejtë të gjenerojë "të ardhurat e dedikuara" nga burime të caktuara, të cilat në rastin e ZRRE-së përfshijnë taksat e licencimit. Kjo gjithashtu parashikohet nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, i cili përcakton se "të ardhurat e dedikuara" janë ato të ardhura që rrjedhin nga një burim i caktuar i të ardhurave, dhe agjenci të tilla nuk do të kërkojnë alokime të granteve nga Buxheti i Kosovës.

4.1 Planifikimi i të hyrave të ZRRE-së

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, ZRRE është një agjenci jofitimprurëse dhe duke pasur parasysh këtë status, të ardhurat dhe shpenzimet e paraqitura në këtë Plan të Punës kanë për qëllim



zgjerimin e të dhënave financiare për të ardhurat dhe shpenzimet e ZRRE-së, por jo për rezultatet financiare, sepse është e qartë se ZRRE nuk është një organizatë fitimprurëse. Që nga themelimi, ZRRE ka mbledhur të ardhurat e saj të dedikuara nga të gjithë të licencuarit në Kosovë. Të hyra e prezantuar në tabelën më poshtë janë planifikuar për arkëtim në periudhën tjetër 3 vjeçare (2020-2022).

<i>Planifikimi i të hyrave për vitin 2020</i>	<i>Planifikimi i të hyrave për vitin 2021</i>	<i>Planifikimi i të hyrave për vitin 2022</i>
1,300,000€	1,300,000€	1,300,000€

Siç u përmend më herët, ZRRE ka gëzuar mbështetjen financiare të donatorëve të ndryshëm, përfshirë BE, USAID, Bankën Botërore, KfW dhe donatorë të tjerë në përbushjen e detyrimeve ligjore. ZRRE do të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të kërkuar ndihmë financiare të donatorëve. Mungesa e mbështetjes së donatorëve do të ketë pasoja serioze në buxhetin e ZRRE-së dhe përvoja e kaluar sugjeron që vështirësitë në zbatimin e buxhetit në mënyrë të pavarur mund të paraqesin pengesa të tjera në këtë drejtim.

4.2 Të hyrat dhe Shpenzimet

Ashtu si vitet e kaluara, ZRRE ka marrë një formular buxheti për të plotësuar Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, një dokument i hartuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Ky lloj i planifikimit të buxhetit për një afat të mesëm gjithmonë ka qenë dhe vazhdon të jetë i papërshtatshëm për ZRRE-në, për shkak të kërkesave specifike të ZRRE-së. Siç kemi thënë shumë herë në të kaluarën, ky format mund të jetë i përshtatshëm për Qeverinë e Republikës së Kosovës, por jo për ZRRE-në. Buxheti i planifikuar i ZRRE-së, sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, është i vështirë për tu përpiluar, dhe në këtë kuptim, sipas kufive buxhetor të përgatitur nga MF ne kemi përgatitur të dhënat siç kërkohet nga Qeveria.

Tabela e më poshtme paraqet trendët e vlerësimeve sipas Kornizës Afatmesme të shpenzimeve për vitet 2020-2022.

	<i>Viti 2020</i>	<i>Viti 2021</i>	<i>Viti 2022</i>
Totali	890,075	902,705	905,348
Nr. i punëtorëve	36	36	36
Pagat dhe Mëditjet	526,075	528,705	531,348
Mallrat dhe Shërbimet	270,000	270,000	270,000
Shpenzimet Komunale	22,000	22,000	22,000
Subvencionet dhe	0.00	0.00	0.00



Transferet			
Shpenzimet Kapitale	72,000	82,000	82,000
Burimet e Financimit			
Grantet qeveritare	0.00	0.00	0.00
Të hyrat vetanake	890,075	902,705	905,348
Financimet nga			
huamarrjet	0.00	0.00	0.00
Grantet nga donatorët	0.00	0.00	0.00

Në bazë të legjislacionit në fuqi, ZRRE ka të drejtë të mbledhë të ardhura vetëm për nevojat e veta, pa i ngarkuar konsumatorët me shpenzime shtesë, nëse nuk është rreptësisht e nevojshme për kryerjen e detyrimeve ligjore. Nëse ZRRE nuk arrin të shpenzojë të ardhurat e mbledhura nga të licencuarit, këto fonde do të transferohen si të ardhura për vitin e ardhshëm, dhe nuk do të transferohen në Buxhetin e Kosovës, duke marrë parasysh faktin se këto janë të ardhura të dedikuara, dhe nuk mund të përdoren për ndonjë aktivitet tjetër përveç aktivitetit të dedikuar.

4.3 Donacionet

ZRRE ka gëzuar mbështetje të fortë të donatorëve në ushtrimin e përgjegjësisë së saj rregullative. Kjo mbështetje duhet të vazhdojë edhe më tej, duke marrë parasysh vështirësitë financiare që ZRRE mund të ketë për të marrë mbështetje teknike në aktivitete specifike në lidhje me transformimin e tregut të energjisë, siç është integrimi rajonal i tregut, dhe konkretisht integrimi i tregut të Kosovës me tregun e Shqipërisë, si një nga prioritetet kryesore të ZRRE-së.

Gjithashtu, ZRRE ka nevojë për mbështetje teknike për të përforcuar zbatimin e projektit më të madh në sektorin e energjisë, Termocentralin Kosova e Re dhe projekte të tjera që lidhen posaçërisht me burimet e ripërtëritshme të energjisë. ZRRE në veçanti ka nevojë për mbështetje në modifikimin e Skemës Mbështetëse të BRE-ve, dhe kalimin e saj nga skemat e tanishme të mbështetjes të ndërtuara mbi Tarifën Nxitëse në skemat e ardhshme konkurruese.

Ky plan mund të ndryshohet dhe azhurnohet në përputhje me procedurat në fuqi për miratimin e tij.



5 Shtojca I Plani i veprimit

Ref	Detyra	Objektiva	Data e përmbushjes së caktuar dhe Personat Përgjegjës
1	Vlerësimi i Konkurrencës	Është një vlerësim për të zhvilluar masat që duhet të merren për të promovuar konkurrencën efektive, dhe në mënyrë të veçantë, për të përcaktuar nëse kapacitetet e gjenerimit të energjisë elektrike dhe furnizimit t'u mundësohet të sigurojnë një konkurrencë efektive. Ky raport do të paraqesë gjetjet e ZRRE-së nëse ka apo jo konkurrencë efektive në furnizim.	Raporti përfundimtar do të publikohet sipas detyrimeve ligjore. Departamenti për Treg të Energjisë, Departamenti për Çmime dhe Tarifa Departamenti Ligjor dhe i Licencimit, TM1 - 2020, dhe TM1 - 2022,
2	Metodologjia e Sigurisë së Furnizimit	Qëllimi i Rregullatorit është që të zbatojë praktikën më të mirë të përdorur në Evropë në bërjen e vlerësimeve të tij dhe të rishikojë këtë metodologji herë pas here në përputhje me praktikën më të mirë. Metodologjinë për vlerësimin e sigurisë së furnizimit (SF) ka për qëllim që të vendos (i) Parimet që do të zbatohen në përcaktimin dhe matjen e SF; (ii) Përgjegjësitë e palëve për zbatimin e këtyre parimeve; dhe (iii) parashikimin e të dhënave për llogaritjen e nivelit të SF që pritet në Kosovë brenda afatit prej pesë deri në pesëmbëdhjetë vite të paraparë në ligj.	Departamenti për Treg të Energjisë, Departamenti për Çmime dhe Tarifa, Departamenti Ligjor dhe i Licencimit,



3	Deklaratë mbi Sigurinë e Furnizimit në Kosovë (2019-2020)	<p>Në përputhje me nenin 42, paragrafi 3, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Rregullatori publikon një raport të detajuar të monitorimit të sigurisë së furnizimit çdo 2 vjet, më së voni deri më 31 korrik.</p> <p>Funksionimi efektiv i sektorit të energjisë elektrike dhe nevojës për investime, veçanërisht në gjenerim, kërkon ristrukturimin e sektorit dhe liberalizimin e tregut, por edhe forcimin e konkurrencës. Për të arritur objektiva të tilla, janë marrë një mori masash, përfshirë ndryshimet në legjislacionin e energjisë, dhe harmonizimin e mëtutjeshëm të legjislacionit sekondar, miratimin e dokumenteve të ndryshme, duke përfshirë edhe "Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut në Kosovë". Këto dokumente, dhe aktivitetet e shtuara në zbatimin e tyre, do të përcaktojnë masat e nevojshme për aranzhimet tregtare, për të siguruar tërheqjen e investimeve vendore dhe të huaja për t'i shërbyer zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike në Kosovë.</p>	<p>Deklarata mbi Sigurinë e Furnizimit në Kosovë (energji elektrike, gaz natyror dhe naftë) publikohet çdo 2 vjet; do të publikohet në Korrik 2019 dhe korrik 2021.</p> <p>Departamenti për Treg të Energjisë, Departamenti për Energji Termike dhe Gaz</p>
---	---	--	--



4	<p>Auditimi teknik dhe financiar i investimeve kapitale ne rrjet (OSSH dhe OST)</p>	<p>Ne mënyre qe të kemi një pasqyre te detajuar te kualitetit te investimeve ne rrjet, do te përgatitet një vlerësim i përafërt i buxhetit te nevojshëm bazuar ne terma te referencës për realizimin e auditimit te investimeve.</p>	<p>Afati për vlerësimin e kostove te aktivitetit te auditimit – Maj 2020, ndërsa realizimi i auditimit – qershor 2021</p> <p>Departamenti për tarifa dhe çmime</p> <p>Departamenti i tregut te energjisë</p>
5	<p>Monitorimi i ndërmarrjeve të energjisë</p>	<p>ZRRE do të bëjë monitorimin e ndërmarrjeve të energjisë në vend sipas Programit të Monitorimit. Monitorimi do të përfshijë, por jo i kufizuar, si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbledhjen e të dhënave dhe informatave përkatëse; - Analizën dhe verifikimin e të dhënave për realizimin e kostove operative, kostove kapitale (investimeve) dhe të hyrave; - Vlerësimin dhe verifikimin e realizimit të parametrave të prodhimit dhe furnizimit me energji, si dhe humbjet në rrjetet përkatëse; - Monitorimi përmbushjes së kushteve të licencave dhe i pajtueshmërisë me dispozitat përkatëse të licencave; - Monitorimi i zbatimit të rregullave, udhëzimeve dhe Vendimeve të nxjerra nga ZRRE. 	<p>Përgatitja e Raporteve respektive të monitorimit në baza vjetore (2020 – 2022) dhe Raporteve të Monitorimit ‘ad hoc’</p> <p>Të gjitha Departamentet</p>



6	Skema Mbështetëse për BRE	Rishikimi i skemës mbështetëse për BRE, për kalimin në mënyra konkurruese të mbështetjes, procedurave dhe çështjeve tjera.	<p>Tetor 2020</p> <p>Departamenti Ligjor dhe i Licencimit, Departamenti për Treg të Energjisë, Departamenti për Çmime dhe Tarifa</p>
7	Rregulla për Gjenerator vetekonsum.	<p>Rishikimi i skemës aktuale mbështetëse në lidhje me Gjeneratorët për vetekonsum, e cila do të jetë një rregull e ndare nga skema aktuale mbështetëse.</p> <p>Ky rregull për qëllim që ZRRE-ja të përcaktojë se si do të trajtohen të gjithë konsumatorët vet-konsum përputhje me udhëzimet në fuqi nga SKE.</p>	<p>Prill 2020</p> <p>Departamenti Ligjor dhe i Licencimit, Departamenti për Treg të Energjisë, Departamenti për Çmime dhe Tarifa</p> <p>Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve</p>
8	Rregulla për Standardet e Cilësisë së Shërbimeve	<p>Rregulla për Standardet e Cilësisë së Shërbimeve të energjisë elektrike është aprovuar në korrik të vitit 2019, në të cilën janë përshkruar qartë treguesit e cilësisë së shërbimit të energjisë elektrike për konsumatorët, lidhur me shërbimet e ofruara, furnizimin e pandërprerë të energjisë elektrike dhe cilësinë e tensionit. Në Rregullën e lartcekur janë të përcaktuara Standardet e përgjithshme dhe Standardet e garantuara/minimale për treguesit e cilësisë së shërbimit. Pas aprovimit të Rregullës është e domosdoshme të krijohet grupi punues në mes të të gjithë aktorëve të sektorit nën</p>	<p>Aprovimi nga Bordi i Vlerave të Standardeve të përgjithshme dhe Standardet e garantuara/minimale për treguesit e cilësisë së shërbimit duhet të bëhet në fund të tetorit 2020.</p> <p>Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve</p> <p>Departamenti për Treg të Energjisë, Departamenti për Çmime dhe Tarifa,</p>



		udhëheqjen e ZRRE për të përgatitur një raport me të gjitha vlerat e treguesve si dhe pastaj të shikohet mundësia edhe e përcaktimit të vlerave për kompensim financiar bazuar në rregullën e lartcekur.	
9	Metodologjia e taksave për kyçje OSSH	Qëllimi i kësaj metodologjie është që të sigurojë procedura gjithëpërfshirëse për përdoruesit dhe përdoruesit e ardhshëm të sistemit të shpërndarjes, të cilët kërkojnë kyçje të reja ose modifikime të lidhjeve ekzistuese dhe të ofrojë informata të mjaftueshme për taksat e kyçjes që do të zbatohen në sistemin e shpërndarjes.	Aprovimi nga Bordi i kësaj metodologjie pritet të bëhet kah fundi i Prillit 2020. Departamenti për Treg të Energjisë, Departamenti për Çmime dhe Tarifa, Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve
10	Aprovimi i Bilanceve të Energjisë Elektrike dhe Termike	Në përputhje me përgjegjësitë ligjore të ZRRE-së për aprovimin e Bilanceve afatgjata dhe vjetore të energjisë elektrike dhe energjisë termike, aktivitetet do të përfshijnë: Shqyrtimin, komentimin dhe finalizimin e bilanceve të energjisë elektrike dhe termike si dhe finalizimin e bilancit të integruar (përbashkët) të energjisë elektrike dhe termike, për publikim nga ZRRE-ja.	Aprovimi nga Bordi i ZRRE-së në çdo fund vit për Bilancit vjetor të energjisë dhe çdo 2 vite për Bilancet e energjisë afatgjata. Departamenti për Treg të Energjisë, Departamenti për Energji Termike dhe Gaz
11	Aprovimi i Planit vjetor të humbjeve	Plani vjetor i humbjeve përfshinë vlerësimin e	Departamenti për Treg të



	në shpërndarje	humbjeve teknike dhe konsumin e paautorizuar të energjisë elektrike, si dhe zhvillimin dhe zbatimin e masave për reduktimin e humbjeve	Energjisë
12	Dhënia e pëlqimit për Adekuacinë e gjenerimit	Ky dokument kërkohet të përgatitet nga KOSTT çdo dy vite dhe të analizohet dhe të ipet pëlqimi nga ZRRE. Dokumenti përmban elemente nga Bilanci afatgjatë dhe planet zhvillimore 10 vjeçare, por kërkohet nga ENTSO-E	Departamenti për Treg të Energjisë
13	Siguria kibernetike	Finalizimi i koncept dokumentit për siguri kibernetike	Finalizimi i koncept dokumentit në Prill 2020 Grupi punues
14	Planet Zhvillimore të ndërmarrjeve energjetike	Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe Operatorët Shpërndarjes së energjisë termike i dorëzojnë në ZRRE planin 10 vjeçar për zhvillimin e rrjetit në bazë të kërkesës dhe furnizimit aktual dhe të parashikuar pas konsultimit me të gjithë akteret relevant. ZRRE do të ndjek një proces të konsultimit gjatë procesit të miratimit të planeve afatgjata zhvillimore të rrjetit, duke marrë parasysh dokumentet – strategjitë dhe	Përgatitja për aprovim e Planeve Zhvillimore Azhurnimi i Planeve zhvillimore në baza vjetore Departamenti për Treg të Energjisë, Departamenti për Energji Termike dhe Gaz



		planet - në nivel nacional dhe rajonal.	
15	Metodologjia për përgatitjen e Planeve zhvillimore	Si pjesë e projektit të NARUC për përpilimin e Planeve zhvillimore dhe nevojës për të përcaktuar mënyrën adekuate të përpilimit të Planeve zhvillimore nevojitet të përgatitet kjo metodologji.	Fundi i Marsit 2020 Departamenti për Treg të Energjisë
16	Përgatitja e Raporteve vjetore	Sipas nenit 10 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE përgatitë Raportin vjetor për vitin paraprak dhe dërgon në Kuvend jo më vonë se me 31 mars të vitit aktual.	Bordi i ZRRE-së, Drejtori Menaxhues, Departamentet
17	Tregu i përbashkët Kosovë-Shqipëri	Qeveria e Kosovës dhe Shqipërisë janë pajtuar në parim për bashkëpunim të mëtutjeshëm më synim të themelimit të tregut të përbashkët të energjisë elektrike ndërmjet të dy vendeve. Faza e parë e këtij aktiviteti mund të kërkoj një rishikim të obligimeve të të licencuarve dhe të dizajnit të tregut ekzistues	Aktivitet i vazhdueshëm gjatë periudhës Departamenti Ligjor dhe i Licencimit, Departamenti për Treg të Energjisë, Departamenti për Çmime dhe Tarifa
18	Azhurnimet vjetore sipas Rregullave për Përcaktimin e Çmimeve	Mbledhja e të dhënave të realizuara, krahasimi me të lejuarat, Vlerësimin e nivelit të kostove etj. Pranimi i komenteve nga palët e interesit; Analizimi i komenteve dhe përgatitja finale e dokumentit.	Finalizimi i raporteve për vendimmarrje nga Bordi i ZRRE-së në çdo vit relevant tarifor Departamenti për Çmime dhe Tarifa



19	Shqyrtimeve tarifore për ndërmarrjet e energjisë termike	<p>Zhvillimin / revidimin / modifikimin e tabelave të raporteve rregullative mostër, të cilat janë bazë për paraqitjen e të dhënave teknike dhe financiare në kuadër të aplikacioneve tarifore Modifikimin dhe finalizimin e Modelit për llogaritjen e të Hyrave të lejuara dhe tarifave.</p> <p>Inicimi i shqyrtimit tarifor, kërkesa për të dhëna dhe informata në kuadër të aplikacioneve tarifore</p> <p>Shqyrtimet dhe vlerësimet e aplikacioneve tarifore, përfshirë edhe hartimin e komenteve</p> <p>Hartimi i raporteve përkatëse për përcaktimin e të Ardhurave të lejuara dhe tarifave të ngrohjes qendrore</p> <p>Finalizimi i shqyrtimit tariforë, Vendimet dhe Raportet Respektive të finalizuar.</p>	<p>Finalizimi i shqyrtimit tariforë, Vendimet dhe Raportet Respektive të finalizuara Në baza vjetore</p> <p>Departamenti për Energji Termike dhe Gaz</p>
20	Miratimi i Kodeve dhe procedurave të ndërmarrjeve të energjisë	<p>Një numër i procedurave dhe rregullave të reja janë miratuar nga ZRRE-ja, dhe disa të tjera priten të aprovoen nga ZRRE.</p> <p>ZRRE do të punoj ngushtë me të licencuarit përkatës për ti identifikuar dhe zhvilluar instrumentet e nevojshme ligjore për të lejuar implementimin e plotë të Legjislacionit në fuqi</p>	<p>Të gjitha Departamentet</p> <p>Në vazhdimësi gjatë tërë periudhës së planit të punës</p>
21	Kriteret për Derrogim	<p>ZRRE-ja duhet të përgatisë procedurë për kriteret të cilat duhet aplikuar për derrogim të neneve të Kodeve teknike. Kjo</p>	<p>Departamenti për Treg të Energjisë,</p> <p>2020</p>



		është kërkesë edhe nga SKE.	
22	Aprovimi i Derrogimeve	ZRRE-ja duhet të analizoj dhe aprovoj derrogimet nga kodet e rrjetit sipas kërkesës nga të licencuarit.	Departamenti për Treg të Energjisë, Në bazë të kërkesave
23	Përgatitja e procedurave të organizimit dhe funksionimit të ZRRE-së	ZRRE-ja duhet të amendamentoj rregulloret e brendshme në të cilat duhet të përshkruhen procedurat e qarta të funksionimit të brendshëm të ZRRE-së si dhe të shqyrtoj organizimin e brendshëm të ZRRE-së.	Aprovimi nga Bordi fundi i Qershorit 2020 Bordi i ZRRE-së , Drejtori Menaxhues, Departamentet
24	Buxheti i ZRRE-së	Të gjitha të dhënat dhe informacionet në lidhje me financat e ZRRE-së janë të orientuara drejt prezantimit të aspektit të rrjedhës së parasë në vend të rezultateve financiare. Prej vitit 2006 ZRRE ka filluar të gjenerojë të hyra nga taksat e licencave në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, si tarifa të inkasuara nga të licencuarit, duke i mundësuar në këtë mënyrë ZRRE-së që të veprojë si rregullator i pavarur financiarisht. Rishikimi i Planifikimit Buxhetor me qëllim të përmbushjes së detyrimeve ligjore	Fundi i Qershorit të çdo viti (2019-2022) Bordi i ZRRE-së



25	Monitorimi i shitblerjes se energjisë elektrike	Monitorimi shitblerjes se energjisë elektrike nënkupton monitorimin e aktiviteteve të shitblerjes së energjisë përfshirë edhe importet dhe eksportet. Për këtë do të përgatitet raport.	Përfundimi i Raportit 2020 Departamenti për Treg të Energjisë
26	Aprovimi i Rregullës për REMIT	Grupi punues ka draftuar një draft Rregull te përbashkët për te gjitha vendet anëtare te Sekretariatit e cila duhet te përshtatet me ligjet aktuale ne Kosove.	Afat për finalizimin e këtij dokumenti Mars 2020 Departamenti Ligjor dhe i Licencimit, Departamenti për Treg të Energjisë, Departamenti për Çmime dhe Tarifa
27	Ndhima shtetërore	Sipas udhëzimeve për ndihmën shtetërore dhe legjislacionit vendor ne lidhje me ndihmën shtetërore, jemi të obliguar qe te raportojmë për aspekte te cilat lidhen skemat mbështetëse për energji te ripërteritshem dhe forma tjera mbështetëse eventuale.	Mars 2020 Departamenti për tarifa dhe çmime Departamenti i tregut te energjisë
28	Mbrojtja e konsumatorëve në nevojë	ZRRE duhet të sigurohet nëse ka kushte minimale të nevojshme për të mbrojtur konsumatorët, në nevojë, duke mos penguar konkurrencën efektive në treg. Në këtë kontekst, do të jetë detyra e rregullatorit të	Përgatitja e studimit shtator 2019 Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve , Departamenti për Çmime dhe Tarifa



		<p>përcaktojë nëse çmimet janë të arsyeshme, lehtësisht dhe qartë të krahasueshme, transparente dhe jo-diskriminuese.</p> <p>Mbrojtja e konsumatorëve në nevojë gjithashtu mund t'i referohet një ndalimi të shkyçjes në kohë kritike. Për shembull, konsumatorët e moshuar me të ardhura jashtëzakonisht të ulëta mund të konsiderohen si të rrezikuara gjatë një dimri të ashpër nëse përdorin energji elektrike për të ngrohur shtëpinë e tyre. Ndalimi mund të marrë formën e kushtit të licencës ose detyrimit.</p> <p>ZRRE-ja duhet të bëjë rishikimin e praktikave me të mira për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë.</p>	
29	Organizimi i një sondazhi/anketimi për konsumatorët	Kënaqshmëria e konsumatorëve me ofrimin e shërbimeve nga ndërmarrjet energjetike.	Sondazhi/Anketimi, do të bëhet në përputhje me mundësitë buxhetore të paktën një herë brenda periudhës 2020-2023 Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve



30	Aktivitete ndërkombëtare	Duke qenë se ZRRE është anëtare e disa organizatave / mekanizmave ndërkombëtare si: ECRB-TKE, CEER, ERRA, pjesëmarrja e stafit përgjegjës në punën e këtyre organizatave të ZRRE është një ndër detyrat dhe aktivitetet që zhvillohen në vazhdimësi. Në kuadër të obligimeve përkatëse, ZRRE-ja ka të emëruar anëtarët e vet në Komisionet / Grupet Punese përkatëse që marrin pjesë aktivisht në punën tyre përmes dhënies së inputeve direkte – të dhënave dhe informatave relevante për sektorin e energjisë në Kosovë.	Të gjitha Departamentet përgjegjëse. Në vazhdimësi.
31	Inicimi i Aktiviteteve për Bashkëpunim Rajonal	Bordi i ZRRE-së do të merr aktivitate për bashkëpunim me Rregullatorët e rajonit përmes memorandumeve të mirëkuptimit	Bordi i ZRRE-së
32	Planifikimi i programit të trajnimit të stafit të ZRRE-së	Kordinimi i zhvillimit dhe implementimit të programit të trajnimit për vitet 2019-2021	Drjetori Menaxhues dhe Të gjitha Departamentet
33	Transparenca, Komunikimi me Publikun dhe Mediat	Marrëdhëniet me publikun dhe transparenca janë të një rëndësie të veçantë për ZRRE-në. Me qëllim të përmirësimit të transparencës Publikimi i njoftimit të takimeve të Bordit, rendit të ditës , komunikatave dhe vendimeve do të bëhet në vazhdimësi .	Njësia e Administratës
34	Buletini i ZRRE-së	Aktet e veçanta dhe vendimet tjera që kanë të bëjnë me licencat dhe tarifat publikohen në faqen zyrtare të ZRRE-së dhe gjithashtu	Të gjitha Departamentet.



		do të publikohen në Buletinin e ZRRE-së. Buletini publikohet të paktën një herë në gjashtë muaj dhe publikohet në faqen elektronike të ZRRE-së.	
35	Sistemet e Mbyllura të Shpërndarjes	Për kryerjen e veprimtarisë së Shpërndarjes brenda një sistemi të mbyllur duhet të miratohet rregulla për kryerjen e kësaj veprimtarie.	Rifat Blakaj, Gani Buçaj
36	Aplikimi për anëtarësimin e ZRRE ne ACER	Në dhjetor të vitit 2019, ZRRE-ja ka kërkuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë mbështetjen e ZRRE-së për Aplikim me qëllim të marrjes së statusit të vëzhguesit në ACER.	Bordi i ZRRE-së
37	Përgatitja e fletëpalosjeve/ broshurave te ndryshme informuese	ZRRE-ja duhet të përgatit fletëpalosje/broshura me qëllim të informimit të konsumatorëve për hapjen e tregut, detyrimet ligjore në mes marrësit dhe dhënësit të shërbimeve, kushteve për dhënie të licencës dhe çështjeve tjera që mendohen të rëndësishme.	Të gjitha departamentet
38	Mjeti për Krahasimin e Çmimeve të energjisë	Mjeti për Krahasimin e Çmimeve është një platformë online e konceptuar për të ndihmuar konsumatorët në krahasimin e çmimeve të energjisë në një treg të hapur si dhe për të ndihmuar rregullatorin në përmirësimin e	Departamenti për Mbrojtjen e konsumatorëve , Departamenti i Tregut të Energjisë



		<p>komunikimit dhe edukimin e konsumatorëve për çështjet që lidhen me hapjen e tregut të energjisë elektrike me pakicë. Projekti mbështetet teknikisht nga USAID/NARUC, përderisa ZRRE do të jetë përgjegjëse për funksionalizimin e tij.</p> <p>Në nivelin e shitjes me pakicë, blerja e energjisë elektrike mund të jetë një proces i komplikuar, veçanërisht për konsumatorët që nuk janë të njohur me sektorin e energjisë. Siç dëshmohet nga hapja e tregut të energjisë elektrike me pakicë në SHBA dhe BE, edukimi i konsumatorëve është çelësi për krijimin e një atmosfere që inkurajon transparencën dhe investimet.</p>	
39	Ridizajnimi i faqes elektronike të ZRRE	<p>Pas më shumë se pesëmbëdhjetë vjet të krijimit të faqes elektronike është esenciale ridizajnimi i saj, në mënyrë që të përshtatet me ndryshimet e reja në sektor dhe ato të teknologjisë informative. Në dhjetor të vitit 2019 përmes procedurave të prokurimit është kontraktuar kompania e cila do të punoj në ridizajnimin e faqes elektronike të ZRRE-së.</p>	<p>Afati për përfundimin e ridizajnit të faqes elektronike marsi 2020</p> <p>Të gjitha departamentet</p>
40	Metodologjia e Llogaritjes së çmimit	<p>Kjo metodologji është për përdorim të brendshëm të ZRRE-së e cila ka për qëllim</p>	<p>Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve në</p>




	referent për energji nga BRE-të.	përbushjen e obligimeve për krijimin e çmimit referent për energji nga burimet e kualifikuara të ripërtërishme, për energjinë e cila shitet nga Operatori i Tregut tek furnizuesit	bashkëpunim me Departamentin e tregut
41	Tarifat nxitëse për Biomasaë	ZRRE do të zhvilloj metodologjinë e përcaktimit të tarifës nxitëse për Energjinë e prodhuar nga Biomasa	Përfundimi i Raportit dhe Metodologjisë fundi i marsit 2020 Departamenti për Tarifa dhe Çmime, Departamenti për Energji Termike dhe Gaz

Miratuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji më 26 dhjetor 2019

Bordi i Rregullatorit:


Arsim Janova, u.d. Kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar